



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3233/10 prot.

Datë 11.12.2025

V E N D I M
Nr.1843/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.12.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 1758/2025, datë 27.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-65357-10-16-2025, me objekt: “Mirembajtje te rrugeve administrative (nderhyrje emergjente per pastrim bore.”, me fond limit 4,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Shehu” SHPK, me NIPT J66702707S dhe adresë: Ndertesa 1- kateshe, me zone kadastrale nr. 2592 dhe me nr. pasurie 440, ne rrugen nacionale Peshkopi, Dibër
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Bulqizë me adresë Lagja “Minatori”, Bulqizë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen

e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 27.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1758/2025 ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Shehu” SHPK në procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-65357-10-16-2025, me objekt: “Mirembajtje te rrugeve administrative (nderhyrje emergjente per pastrim bore.”, me fond limit 4,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “Shehu” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim duke e kualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentur veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shehu” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 6685/1 prot., datë 09.12.2025 protokolluar me tonën nr. 3233/7 prot., datë 11.12.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. Nr.1758/2025 datë 27.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-65357-10-16-2025, me objekt: “Mirembajtje te rrugeve administrative (nderhyrje emergjente per pastrim bore.”, me fond limit 4,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë..

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 6685/1 prot., datë 09.12.2025 protokolluar me tonën nr. 3233/7 prot., datë 11.12.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1758/2025 datë

27.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-65357-10-16-2025, me objekt: “Mirembajtje te rrugeve administrative (nderhyrje emergjente per pastrim bore.”, me fond limit 4,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë..

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.1758/2025 datë 27.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka rivlersuar procedurën e prokurimit object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.1758/2025 datë 27.11.2025, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-65357-10-16-2025, me objekt: “Mirembajtje te rrugeve administrative (nderhyrje emergjente per pastrim bore.”, me fond limit 4,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë..
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiovent Zguro

